



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
QYTETËRIM FRANCEZ

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orëmësimore: 20 leksione, 20 seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndëme detyrim

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë mëton të japë një panoramë të përgjithshme të qytetërimit francez, duke u mbështetur në një numër piketash : njohuri gjeografike, historike, politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të jetës së përditshme.

Objektiva të përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri të përgjithshme dhe informacione mbi kulturën, qytetërimin francez dhe Francën e ditëve tona.

Objektiva specifike lëndore:

Lënda synon që studenti :

- të marrë njohuri dhe t'i thellojë ato mbi vendin gjuhën e të cilit po studion
- të relativizojë qëndrimet dhe sjelljet e tij nga një perspektivë ndërkulturore
- të dijë të orientohet dhe të sillet në një realitet dhe shoqëri të ndryshme nga ajo ku jeton
- të jetë në gjendje të shfrytëzojë literaturë në frëngjisht duke e përdorur në mënyrë të përshtatshme

Rezultate të pritshme:

Studenti nuk përvetëson vetëm gjuhën frënge por njeh dhe aspekte të ndryshme të kulturës dhe shoqërisë franceze, përtë mundur të orientohet dhe integrohet në të.